

BESARTA QALLIAJ

PERIUDHA, FRAZA E FJALIA E PËRBËRË SI NJËSI SINTAKSORE
NË GRAMATIKAT E SHQIPES

Sa i takon kategorisë më të madhe sintaksore, periudhës, gjuhëtarët e autorët e teksteve që kemi marrë në analizë, pothuajse bashkohen ose afrohen mjaft në trajtimin e saj, grupimet dhe qëndrimet ndaj përbërësve predikativë. Në traditën tonë gramatikore në fushë të sintaksës, që përbën një hark kohor më pak se një shekull, janë përdorur terma të ndryshëm për të njëjtën njësi sintaksore, si: *periudhë*, *frazë* apo *fjali e përbërë*.

Po shohim përdorimin e këtyre termave në mënyrë kronologjike, sipas autorëve të disa librave të sintaksës që nga dhjetëvjetëshi i dytë i shekullit XX. Kështu, Aleksandër Xhuvani, në tekstin “*Njohunit e para të Syndaksës Shqipe*” pjesë e parë për klasët e Nalta të Fillores (Vlorë 1922), jep njohuri për *periudhën*, duke e përqasur atë me fjalinë dhe përkufizon: “*Periudhë quhet bashkimi i dy a ma shumë fjalive të lidhuna me një mënyrë, qi të rrëfejnë një mendim të plotë, sikurse: zogjt’fluturojnë n’erë e peshqit bajnë not n’ujë. Në një periudhë janë aqë fjali sa janë edhe kallëzuesit foljorë*”. (paragrafi 12, f. 32-33). Të këtij autori janë edhe emërtimet që dalin nga përbërësit e kësaj njësie, si:

- *periudhë me fjali të rendituna bashkë e të lidhuna bashkë*
- *farët e fjalive të varme, të cilat mund të jenë:*
 - kryefjalë të fjalisë së parë*
 - kundrina të fjalisë së parë*
 - mund të dëfthejnë kohë*
 - kusht*
 - shkak*.¹

Ndërsa tek pjesa e dytë e kësaj sintakse, *për klasat e ulta të shkollavet të mesme*, Xhuvani jep njoftime më të thelluara edhe për fjalitë e rendituna bashkë - ku përmbledh fjalitë që përbëjnë periudha me bashkërenditje (sindete e asindete), dhe tregon ç’janë *periudhat me fjali të lidhuna bashkë*, për të cilat shprehet: “*Fjalit’ e lidhuna bashkë mund të shërbejnë si kryefjalë të fjalisë së parë, si kundrinë të saj, ase mjund të kallzojnë kohën, shkaku, kushtin etj., për të cilin bâhet dishka në fjalinë e parë; prandaj këto fjali marrin emna të ndryshëm, sikurse do të shohim*.”² Pas kësaj autori shtjellon më vete fjalitë kryefjalore, fjalitë kundrinore (duke i quajtur fjali me predikativitet edhe ato me forma të pashtjelluara foljore e duke i quajtur fjali të pashtjellme),³ fjalitë kohore, fjalitë

¹ A. Xhuvani, *Njohunit e para të Sintaksës shqipe*, Pjesë e parë... Vlorë, 1922, f. 44-45

² A. Xhuvani, *Sintaksa shqipe*, Pjesë e dytë për klasët e ulta të shkollavet të mesme, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1938, f. 31.

³ Po aty, f. 32.

mënyrore, fjalitë vendore, fjalitë shkajkore, fjalitë lidhore (përcaktore – shënimi im, B. Qalliaj), fjalitë qëllimore, fjalitë ndërmjetëse, fjalitë krahasore, fjalitë kushtore, fjalitë rrjedhore, fjalitë konçesive (lejore, shënimi im, B. Qalliaj).

Ilia Dilo Sheperi, te “Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskënishtes, për shkollat e mesme” (Vlorë, 1927), në pjesën e katërt “Sindaksa”, pasi i ndan fjalitë në të thjeshta, kur kanë vetëm kryefjalë dhe kallëzues; të plotësuar, kur kanë dhe ndonjë plotës, shkruan: “Për t’u shfaqur plotësisht një mendim, shumë herë bashkohen dy a me shumë fjali kryesore të thjeshta ose të plotësuar, të cilat përbëjnë kështu një periudhë”; pasuar me shënimin: Dhe një fjali përbën një periudhë, kur e shfaq mendimin të plotë (në paragrafin 390, f. 140), kurse më poshtë shprehet se “shumë periudha që kanë lidhje me njerajetrën për të shfaqur të gjithë mendimet mbi një çështje, përbëjnë ligjëratën”, duke aluduar për një njësi mbisintaksore, e cila në gjuhësinë moderne quhet tekst.⁴ Te ky autor gjejmë ndarjen *Fjali të bashkërenditura*, të grupuara sipas lidhëzave bashkërenditëse: *shtuese, dalluese, kundërshtore, përmbylltore*; kurse tek ajo që ai e quan *Bashkëlidhja*, jep shpjegimin e periudhës, duke shkruar: “Nga dy fjali të bashkëlidhura ajo që plotëson tjetrën merr përpara një nga lidhëzat e bashkëlidhjes, ose një nga përemrat a ndajfoljet lidhore, dhe quhet fjali e varme ose e dytë. Fjalia që plotësohet prej një fjaliqe së varme quhet fjali e parë e sajë dhe mund t’ jetë fjali kryesore ase e pavarme, ose quhet fjali e varme prej një tjetëre, p.sh.: U – habita kur i pashë që rrinin pa punë.”⁵ Sheperi është i pari që zbaton parimin e paralelizmit funksional sintaksor në klasifikimin e fjalive të nënrenditura. Ai shkruan: “Fjalit e varme, si pjesë të fjalive kryesore, shërbejnë në to:

- a) në vend të emërit si kryefjalë, kallëzues, kundrina ose ndajshitime;
- b) në vend të mbiemërim, si plotës të ndonjë emëri të fjalis kryesore;
- c) si plotës qëllimi (fjali qëllimi);
- d) si plotës shkaku (fjali shkaku);
- e) si plotës kohe (fjali kohe);
- f) si plotës kushti (fjali kushti);
- g) si plotës që shfaq të kundërtën (fjali kundërshtore)⁶; pas shembullit “Ndonse punon, nuk fiton” – bëhet fjalë për fjalinë lejore (shënimi im, B. Qalliaj).

Në tekstin më të plotë të sintaksës të botuar deri atëherë, “*Sintaksi i shqipes për shkollat e mesme*”, **Justin Rrota**, në vend të termave *frazë* apo *periudhë* përdor termin *fjali e përbame* dhe njohuritë për këtë jepen në pjesën e quajtur “*Dega e dytë e Sintaksit*”, të cilën e ndan në “*Fjali e përbame*” nga fjalitë e para (të pamvarshme) dhe fjalitë e dyta (të mvarshme). Në kreun e parë klasifikon: *Fjalia e përbame, ndërtue prej fjalish të para*, ku hyjnë fjali “katër nduersh”

⁴ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, sidomos e toskënishtes, Vlorë 1927, f. 140.

⁵ Po aty, f. 171.

⁶ Po aty, f. 172.

Periudha, fraza e fjalia e përbërë si njësi sintaksore në gramatikat e shqipes

(llojesh): 1) *Rendore* (kopulative); 2) *Kundërshtore* (adversative); 3) *Shkakore* (kasuale); 4) *Rrjedhore* (konsekutive); kurse në kreun e dytë paraqitet “*Fjalia e përbame prej fjalish së dyta a të mvarshme*”⁷, duke pasur parasysh me këto fjali fjalitë e nënrenditura. Konceptin e periudhave me bashkërenditje, autori e jep me sintagmën *lidhje e përbame, ndërtue prej fjalish së para*, kurse tek fjalitë e përbame prej fjalish së dyta⁸, dallon:

- fjali të subjektit,
- fjali të predikatit,
- fjali të atributit,
- fjali të objektit,
- fjali të advërbjarit.⁹

Dhe, ashtu si Sheperi i shpjegon të ndara kështu, nisur nga paralelizmi funksional gjymtyror, duke zgjeruar grupin e fjalive, të cilat i quan *të advërbjarit*, ndër të cilat veçon:

- fjalitë vendore (lokale),
- fjalitë kohore (temporale), të cilën e ndan në: *njikohore, parakohore, mbaskohore*,
- fjalitë mënyrore (modale),
- fjalitë krahasore (komparative),
- fjalitë rrjedhore (konsekutive),
- fjalitë shkakore (kauzave),
- fjali qëllimore (finale),
- fjalitë qyshkore (kondicionale),
- fjalitë lejore (konçesive).¹⁰

Tek Justin Rrota gjejmë edhe konceptin e fjalive *të përbame shumëfjishë*, ndërsa për termin *periudhë* ky gjuhëtar jep këtë shpjegim: “Sado qi nën këtë emën *perjudhë* dikush thirret edhe fjalën, qi na ma nalt e quajtmë *fjali të përbame*; prap, ma fort, *periudhë* thirret njai grumbull fjalish, ndërtuem me të madhe mjeshtri e hart, qi përmban në veti një mendim të vetëm, por të kryem plotësisht.”¹¹

Në tekstin e parë të pasluftës, hartuar nga **Kostaq Cipoja**, “*Sintaksa*”¹², çështja e kësaj njësie sintaksore trajtohet në një plan të gjerë e teorik. Autori, kur shkruan se sintaksa ndahet në tri pjesë kryesore, nënvizon se: “*pjesa e tretë bën fjalë për konstruktet, d.m.th., si lidhen fjalitë e ndryshme për të formuar një periudhë*”¹³. Po kështu, tek tema “*Farët e fjalive të pavarura*” argumenton se: “*Fjali e pavarur quhet ajo që ka kuptim të plotë vetiu dhe që mund të formojë, ajo*

⁷J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shkodër, 1942, 62, 66.

⁸Po aty, f. 65.

⁹Po aty, f. 65.

¹⁰Po aty, f. 80-94.

¹¹Po aty, f. 105.

¹²K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave,, Tiranë, 1952.

¹³Po aty, f. 3.

vetë, pa ndonjë ndihmë tjetër, një periodë të shkurtër”¹⁴ Më poshtë, K. Cipoja jep përkufizimin dhe një varg karakteristikash të periodës: “Quajmë periodë një radhë fjalish me kuptim të plotë e të vazhduar dhe simetrikisht të ndrequra. Kufit’e periodës përcaktohen me anë të pikës në gjuhën e shkruar, me anë të pushimit të gjatë në gjuhën e folur. Periodë mund të quhet edhe një fjali e vetme, kur është mjaft e zgjeruar dhe shpreh kuptim të plotë: P.sh.: *Gëzimi i kësaj fitoreje të çkëlqyer u turbullua nga lajma e zezë e vdekjes së Pal Dukagjinit*. Nuk ka perioda të formuara vetëm me fjali të varura, aq më pak me fjali të varura të pashtjella”¹⁵. Edhe në vazhdim të trajtimit të problemeve të periudhës, gjuhëtari ynë i njohur i qëndron besnik termit “periodë” (si ndikim i gramatikave të gjuhëve neolatine), duke krijuar sintagmat “periodë hipotetike, periodë me ndërtime të parregullta”, etj. Për termin *periodë hipotetike*, duhet përmendur se në vitin 1914-1915, albanologu austriak Maximilian Lambertz kishte hartuar monografinë e parë gjuhësore (nga fusha e sintaksës), botuar në revistën e madhe të Akademisë së Shkencave të Austrisë, “Indogermanische Forschungen”.

Për herë të parë termi “frazë” (me sa dimë), u përdor në literaturën tonë gjuhësore nga **Mahir Domi** në librin “Gramatika e gjuhës shqipe” Pjesa e dytë, Sintaksa, për shkollat shtatëvjeçare e shkollat e mesme” (Tiranë 1954, me ribotim)¹⁶, krahas termit “periudhë”. Në këtë gramatikë autori shpjegon se grupet e fjalive që shërbejnë për të shprehur një mendim të plotë, më të plotë se mendimi që shpreh në fjali, i quajmë *periudha* ose *fraza*. Periudhat i ndajmë njërën prej tjetrës zakonisht me pikë. (f. 131). Pas kësaj M. Domi arrin në përkufizimin: “*Periudha është një grumbull fjalish, që tregojnë një mendim të plotë. Në një periudhë zakonisht ka aqë fjali, sa ka folje*”. Autori shkon më tej duke i klasifikuar *periudhat në periudha të thjeshta* (me një fjali) dhe *periudha të zgjeruara* (që kanë më shumë se një fjali), një argument i paqëndrueshëm në tekste të mëvona të sintaksës.

Më tepër se një dhjetëvjeçar më vonë, në “Sintaksën e gjuhës shqipe”, botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës (Tiranë 1966), Mahir Domi përdor të dy termat, *frazë* ose *periudhë*, duke shënuar se “disa quajnë *periudhë* vetëm frazën e gjatë, me shumë fjali, me ndërtim pak a shumë të ndërlikuar” (f. 1). Por gjatë paraqitjes së kësaj pjese të disiplinës, anon më shumë nga termi *frazë*, prandaj edhe e përdor më dendur: “Fraza përbën një tërësi nga kuptimi dhe intonacioni”, “fjali që bashkohen për të formuar frazat, nuk i zotërojnë të gjitha tiparet e fjalive të veçuara”, etj. (f. 3). Së fundi, autori jep shpjegime pse përdoren termat me kundërvënien *fjali e thjeshtë – fjali e përbërë*, bën krahasime me termat e përdorur në gjuhë të tjera dhe shpreh mendimin e tij të prerë: “Duke u mbështetur në faktin se si fjalia si fraza përbëjnë tërësira kuptimore e gramatikore të ngjashme, ka gjuhë e tradita gramatikore që përdorin të njëjtin term, duke e quajtur fjalinë *fjali e thjeshtë* dhe frazën *fjali e përbërë*. Kështu ndodh në gjermanisht dhe në rusisht

¹⁴ Po aty, f. 6.

¹⁵ Po aty, f. 15.

¹⁶ Vepër e cituar.

Periudha, fraza e fjalia e përbërë si njësi sintaksore në gramatikat e shqipes

(rus. *Predllozhenie dhe slozhnoje predllozhenje*; gjerm. *Satz, zusammengezetser Satz*).

Është me interes të njihet edhe trajtimi i kësaj kategorie sintaksore – periudhës – nga gramatikani i shquar **Selman Riza**, në pjesën III të Veprës 2.¹⁷ Në fillim të pjesës së dytë për sintaksën e fjalisë së përbërë, autori vë në dukje se gjenerimi i strukturave më të gjera se fjalia e thjeshtë është si pasojë e veprimtarisë së ndërlikuar mendore të njeriut, të cilën duhet ta pasqyrojë gjuha. Ai arsyeton: “...edhe ajo ma e vogla veprimtari mendore do të qëndrojë jo më një të vetëm njësit menduar të thjeshtë por disa njësite mendore të thjeshtë. Prandej soll më një paraqitje analitike shembujsh gramatikorë mund të gjindemi përpara një njambasnjasisi kryekëput të pandërlidhun njësitesh mendorë të thjeshtë.”¹⁸ Pranë këtij parashtrimi teorik, autori tregon se njësitë më të mëdha se fjalitë e thjeshta, pra, *fjalitë e përbame*, krijohen dhe formësohen nga sequenca fjalish të thjeshta, bashkërendohen sipas ligjeve të gramatikës e të gjuhës, duke krijuar njësi më të mëdha. Më tej, sipas traditës sonë sintaksore, ndjek ndarja në *fjali të përbame* me bashkërenditje *përfshimjore*, *përfshimjore-përrjashtore*, *kundërshtore* dhe *përmbylljore*. Për strukturat me raporte pabarazie (hipotaktike), autori emërtion *fjalija përbandjoro-ndënrendore*, ku fjalitë kryesore ose drejtuese quhen *kryefjali*, kurse ato të varura – ndënfjali. Këto të fundit në Sintaksën e Rizës emërtohen si më poshtë:

- ndënfjalija e përtukallxueme
- ndënfjalija ndënanore
- ndënfjalija kallxuese
- ndënfjalija e kundrinës (kundrinore)
- ndënfjalija kohore
- ndënfjalija mënyrore
- ndënfjalija pasojore a konsektive
- ndënfjalija shkakore
- ndënfjalija qëllimore
- ndënfjalija kushtore a kondicionale
- ndënfjalija përlejore a koncesive
- ndënfjalija faktuese a determinate
- ndënfjalija ndajshuese¹⁹

Në vitin 1959 u botua “Sintaksa e Gjuhës Shqipe Pjesa I, për studentët e Institutit pedagogjik 2-vjeçar”, nga **Stefan Prifti**. Që në parathënie autori shënon: “Parimi themelor që kemi pasur këtu parasysh është kombinimi i formës me brendinë, i kërkesave, i kërkesave logjike dhe i kërkesave thjesht gramatikore”. Për gjuhëtarin, sintaksa, në ndërtimin e vet, ndahet në dy pjesë të mëdha: a) në

¹⁷ S. Riza, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 13, Prishtinë, 1997.

¹⁸ Po aty, f. 516.

¹⁹ Po aty, f. 521-528.

sintaksën e fjalisë dhe b) në sintaksën e fjalivet (ose të periudhës). Për herë të parë, sa u takon teksteve shkollë, përdoret këtu termi “sintagmë”, “Njësitë sintagmatike, - shkruan autori, - quhen me terma më të specifikuar, edhe “sintagma apo togje fjalësh”. Fjalinë me pjesë apo gjymtyrë homogjene të përsëritura, ai e quan fjali të ngjizur (apo të përbërë), ndërsa periudha, sipas S. Priftit, “është një sistem fjalish të lidhura gramatikisht midis tyre, që shprehin një mendim të plotë, të mbaruar” (Disp. I, Pj. II, f. 1, 1962). Në vijim, ky studiues shënon mjaft veçori të fjalisë e të periudhës. Kështu, në krahasim me fjalinë, pohohet se periudha paraqit, së pari, një ndryshim kuantitativ, apo sasior. Më poshtë jepet një variant tjetër përkufizimi: “Periudha është një grupim fjalish të lidhura gramatikisht në një tërësi unike, e cila shpreh mendimin të plotë, të shtjelluar, të mbaruar dhe ka një karakter relativ”. (f. 2). Për hierarkinë e fjalisë ndaj periudhës, autori shpjegon se “fjalia, duke hyrë në periudhë, bëhet një element përbërës i saj; prandaj pozita e fjalisë në periudhë është e ngjashme me pozitën e pjesëve të fjalisë në të”. Sikurse lidhjet e fjalëve në fjali, ashtu edhe lidhjet e fjalivet në periudhë janë materializime gjuhësore (gramatikore) lidhjesh dhe raportesh mendimore, që reflektojnë lidhje dhe raporte realë”. (f. 10).

Është me interes të sjellim këtu një shënim të faqes 3 të kësaj pjese: “Në vend të termit tradicional *periudhë*, është përdorur dhe përdoret edhe sot termi *frazë*. Të dyja këto janë fjalë të huaja greke. Fjala *periudhë* (apo *periodë*) është e përbërë nga parashtesa (parafjalë) *peri* dhe nga emri *hodhos* (me theks në fund), që do të thotë në shqip “*udhë*”. Kuptimi fjalë për fjalë, pra i termit *periudhë* do të ishte “*rrugë, rreth*”, rrugë që mbyllet në formë rrethi etj. Përdorimi në sintaksë i termit *periudhë* është i figurshëm, por fort i qëlluar dhe konkretizonjës: ai shpreh idenë dhe e bën të qartë pohimin se mendimi ynë, që përmbyllet në periudhë, shprehet i përfunduar, i mbaruar...”.

Pa u ndalur në ndarjen sosyriane gjuhë-ligjërim, ku termi *periudhë* do të ishte kategori e gjuhës, ndërsa termi *frazë*, kategori e ligjërit, autori i kësaj sintakse shpjegon: “Përkundrazi termi *frazë* është emër foljor (*frasis*) prej foljes *frazein*, që do të thotë “flas, shpreh, them”: ai ka kështu kuptimin e të folurit në përgjithësi, e të shprehurit, e të treguarit me fjalë të atyre që mendojmë. I thonë periudhës edhe *fjali e ndërlikuar apo e përbërë*, por periudha dhe fjalia nuk mund të identifikohen, sikurse nuk mund të identifikohet pjesa me të tërën, gjymtyra e fjalisë me vetë fjalinë. Fjalia është një pjesë, një element përbërës i periudhës”. Dhe përfundon: “Le ta mbajmë, pra, më mirë termin tradicional *periudhë*”.

Me qenë se ky përshkrim panoramik për zhvillimin dhe pasurimin e terminologjisë së disiplinës së sintaksës vjen i pandarë nga përshkrimi i gramatikave dhe vetë shtjellimi i temës lidhet ngushtë me historinë e gramatologjisë shqipe, nuk mund të lihet pa përmendur edhe publikimi që Universiteti i Prishtinës i bën dispensës së prof. Mahir Domit “*Sintaksa e gjuhës shqipe*”.²⁰ Ky tekst mësimor universitar (botuar me ndryshime minimale sipas

²⁰ Prof. M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971, me 145 faqe.

Periudha, fraza e fjalia e përbërë si njësi sintaksore në gramatikat e shqipes

dispensës së autorit në vitin 1967), nis me trajtimin e hollësishëm të gjymtyrëve homogjene, të cilat më vonë, së bashku me *plotësin thirrë, fjalët e ndërmjetme, pasthirrat, gjymtyrët e veçuara*, do të bëjnë pjesë në sintaksën e fjalisë.²¹ Pas këtyre temave (ku na bie në sy termi *cilësor*, që autori e ruan nga Gramatika e gjuhës shqipe e vitit 1954, 1957) kalohet tek të ashtuquajturat *Fjali mungesore*, ndërkohë që krahas këtij termi përdoret edhe *fjali të paplota*. “Nën termin “*fjali mungesore*”, - shkruan autori, - janë përmbledhur fjalitë të karakterit të ndryshëm modelesh e tipash të ndryshëm. Tipari i përbashkët i tyre është mosçfaqja e një ose e disa gjymtyrave dhe mundësia, me gjithë këtë, për të shprehur të plotë një mendim.”²² Nga ky grupim i fjalive, kemi mundur të nxjerrim termat e formuara me këto emërtime dy a më tepër fjalëshe, të cilat Domi i sjell si më poshtë:

- *fjali mungesore të mirëfillta*;
- *fjali mungesore të ligjërit dialogjik*;
- *fjali mungesore brenda frazës*;
- *fjali mungesore të kushtëzuara nga rrethanat*;
- *fjali eliptike*.²³

Më poshtë, në këtë tekst, prof. Domi shtjellon në plan të gjerë kuptimin e termit *fjalitë e pazbërthyeshme* (kupto: *fjalitë e pagjymtyrëzueshme*), të cilat i ndan në nënlloje si vijon:

- *fjali të pohimit e të mohimit*;
- *fjalitë pasthirra*;
- *fjalitë nxitëse*;
- *fjalitë e përshëndetjes*;
- *fjalitë thirrëse (vokative)* ²⁴

Në këtë sintaksë, që mund të quhet *e periudhës* (për faktin që kjo njësi kumtuese zë hapësirën më të madhe të tekstit), është me vend të vihet në dukje paraqitja e lidhjeve me parataksë dhe hipotaksë, karakteristikat kryesore midis këtyre bashkimeve sintaksore, duke vënë në dukje jo vetëm anën formale gramatikore, por, mbi të gjitha, kuptimet që shprehin dhe kalimin tek njëra tjetra. Një gjë e tillë mungon në Sintaksat e mëvonshme universitare dhe parauniversitare që janë botuar në vendin tonë.²⁵

Te teksti mësimor, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, i botuar në Prishtinë, është mjaft interesant dhe i veçantë qëndrimi që mban autori kur paraqet frazën ose *periudhën*, terma, të cilët, te *vështrimi i përgjithshëm*, dalin pothuajse të njëjtësuar. Ja si i shpjegon M. Domi këto njësi kumtuese: “Dy ose më shumë fjalitë që bashkohen me mjete të ndryshme sintaktike e formojnë një tërësi të vetme

²¹ Po aty, f. 3-24.

²² Po aty, f. 25.

²³ Po aty, f. 25-29.

²⁴ Po aty, f. 29-36.

²⁵ Po aty, f. 42-48.

*gramatikore quhen frazë ose periudhë.*²⁶ Gjatë paraqitjes së kësaj njësie, mund të vërehet pa vështirësi se në tekst nuk mbahet një qëndrim i drejtë për afritë e ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet termave *fjali - frazë dhe periudhë*. Aty theksohet se ndërmjet fjalisë e frazës për nga kuptimi nuk ekziston ndonjë ndryshim themelor; ndryshimi është më tepër strukturor: *fjalja është e përbërë prej fjalësh e togje fjalësh, fraza prej fjalish.*²⁷ Ashtu siç kemi nënvizuar edhe për gramatikanë e gjuhëtarë të tjerë para tij, në trajtimin e periudhës (frazës), si kategori sintaksore, Domi shfaqet plotësisht nën ndikimin e logjikës e logjicizmit, kur vijon shpjegimin se ndërsa fjalja i përgjigjet një mendimi, gjykimi përgjithësisht të thjeshtë, fraza i përgjigjet një gjykimi kompleks, të përbërë prej gjykimesh të thjeshta të shprehura prej fjalish. Por edhe fjalja e veçuar e zgjeruar mund të shprehë ndonjëherë mendime po aq komplekse sa edhe fraza. Në këtë pjesë, autori nuk lë pa përmendur se, duke u mbështetur në faktin se si fjalja, si fraza përbëjnë tërësia kuptimore e gramatikore të ngjashme, ka gjuhë e traditë gramatikore që përdorin të njëjtin term, duke e quajtur fjalinë *fjali e thjeshtë* dhe frazën *fjali e përbërë*. Kështu ndodh në gjermanisht e në rusisht (rus. *predlozhenie dhe slozhnoe predlozhenie*; gjer. *Satz, Zusammengeetzte satz*). “Në gjuhë të tjera, vazhdon autori, duke u mbështetur në ndryshimin struktural, ndonjëherë edhe më tepër se kaq, të këtyre dy njësive sintaktike, përdoren terma të ndryshëm. E tillë është edhe tradita e gramatologjisë shqipe. Ndonjë përpjekje që është bërë nga ndonjë studiues (J. Rrota, etj.) për të zëvendësuar termën frazë me “fjali të përbërë”, nuk ka zënë vend.”²⁸ Por fakti tregon se prej më se 3 dhjetëvjeçarësh në tekstet tona parauniversitare ajo përpjekje e Justin Rrotës ka qenë e drejtë dhe ai zëvendësim terminologjik (frazë – fjali e përbërë), ka fituar konsolidim të plotë.

Në mjaft tekste, të punuara nga një brez më i ri gjuhëtarësh, në vitet ’80 e këndej, për nivele masive shkollimi, u bënë edhe ndryshime terminologjike në fushë të sintaksës, përzgjedhje dhe emërtime kategoriale, kryesisht në klasifikimin e gjymtyrëve të dyta. Në “*Librin e gjuhës shqipe*”, 1, 2, 3, 4 (viti i botimit 1985-1986) e në të gjitha ribotimet e mëvona për shkollat e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja (R. Përnaska, A. Jashari, L. Harito, L. Bubani, N. Dako e S. Bobrati), janë përdorur termat *fjali e thjeshtë* dhe *fjali e përbërë*. Po kështu, në tekstet e gjuhës shqipe për shkollat 8-vjeçare (autorë Bahri Beci, Loredan Bubani e Zamira Gurabardhi), botuar më 1996 dhe ribotuar pothuaj në çdo vit mësimor, duke mos qenë e ndarë morfologjia me sintaksën në libra të veçantë, që nga klasa V deri në klasën VIII, punohet me termat *fjali e thjeshtë*, *fjali e përbërë* (kl. V, f.

²⁶ Prof. M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 37. Këtu autori shënon në fund të faqes: *Disa quajnë periudhë vetëm frazën e gjatë, me shumë fjali, me ndërtim pak a shumë të ndërlikuar. Ka gramatika, sidomos shkollore, që pranojnë se mund të ketë frazë të përbërë edhe prej një fjalie, dhe quajnë frazë edhe një fjalë të veçuar.*

²⁷ Po aty, f. 38.

²⁸ Po aty, f. 39.

Periudha, fraza e fjalia e përbërë si njësi sintaksore në gramatikat e shqipes

248); duke e zgjeruar emërtimin e kësaj të fundit *fjali e përbërë me pjesë të nënrenditura*.

Në veprën “Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Tiranë, 1997, f. 60-64) jepet hierarkia e njësive sintaksore: gjymtyra e fjalisë, togfjalëshi, fjalia, periudha dhe pranohet qenia e “njësisë semantiko-strukturore të përbërë prej fjalish të mëvetësishme a periudhash të ndryshme, e cila ka një përmbajtje të lidhur, të organizuar zakonisht me mjete gramatikore. Mund të quhej *thënie e lidhur*” (f. 64). Në këtë tekst akademik gjithashtu shkruhet se “ka gramatika që përdorin për to (për fjalinë e periudhën) të njëjtin term, *fjali*, duke dalluar fjalinë e thjeshtë, që i përgjigjet fjalisë së mëvetësishme dhe *fjalinë e përbërë*, që i përgjigjet periudhës (f. 61). Gjatë paraqitjes së lëndës në këtë gramatikë normative, përdoren termat fjali e thjeshtë dhe periudhë.

Në një radhë me paraqitjen dhe trajtimin e periudhës (frazës, fjalisë së përbërë), në tekstet tona, e quajmë me vend të sjellim edhe disa risi në terminologjinë e kësaj njësie sintaksore, të cilat mund të shihen në tekstin mësimor universitar të gjuhëtarit të njohur Minella Totoni, ku autori, që në parathënie (pa shtruar diskutime), shkruan: “*Fraza me fjali të nënrenditura është një nga kategoritë më të studiuara të sintaksës së shqipes*” dhe fut në përdorim nga fillimi e deri në fund termin *frazë*, si: *fraza kohore, fraza vendore, fraza mënyrore*, etj.

Libri²⁹ ka 169 faqe, ndahet në dy pjesë, për qëllime studime dhe kudo, në vend të skajit *periudhë*, përdoret nga autori termi *frazë*. Pjesa e parë, emëruar *Mjetet e formësimit të frazës me nënrenditje*, Totoni trajton termin *korrelat-i*, si mjet të organizimit të frazës, por që nuk kënaq si kriter klasifikimi për fjalitë me nënrenditje. Po renditim një numër skajesh gramatikore (sintaksore), krejt të veçanta që ndeshen në këtë tekst mësimor, për të cilat mendojmë se janë formësuar nga autori për shkak të trajtimit të ndryshëm të disa kategorive sintaksore, kryesisht të fjalive me nënrenditje – si përbërës kallëzuesorë të frazës.

- *fjalë mbështetëse* – fjala që rimerret në fjalinë e nënrenditur me anë të mjetit lidhës (f. 18).

- *mjet lidhës hibrid* – është fjala kur fjalia e nënrenditur lidhet me fjalinë kryesore me *ndajfolje + që* dhe *përemër + që* (f. 24)

- *organizim kumtesor i frazës* – ose gjymtyrëzimi aktual i frazës, prej të cilit përftohen rendi neutral dhe rendi afektiv (f. 34, 37).

- *remë e thënies* – kur fjalia e nënrenditur del me rend të prapavendosur (f. 37).

- *temë e thënies* – kur fjalia e nënrenditur është del me rend të paravendosur (f. 37).

- *rend i aktualizuar* – rend i lirë, ku fjala lidhëse del në rolin e temës (f. 43).

²⁹ M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Shblu, Tiranë, 2000.

- *semantika e frazës* – kuptim i frazës me nënrenditje ku do të kuptohet marrëdhënia që vendoset në mes së fjalisë së n/r dhe fjalisë kryesore në tërësi dhe përbërësve të saj (f. 45)

- *qendra kallëzuese e fjalisë* – është marrëdhënia që krijohet midis kryefjalës e kallëzuesit (f. 45).

Në pjesën e dytë, titulluar *Klasat dhe tipat e frazave të përbëra me nënrenditje*, do të gjejmë mjaft terma të pazakontë me ata që ndeshen në libra sintakse të autorëve të tjerë bashkëkohorë, ose pararendës të tij në këtë fushë, si: *fjalë mbështetëse analitike* (f. 48), *frazë filluese dëftore, nxitëse, dëshirore a pyetëse* (f. 48), *fjali e nënrenditur temë* (f. 59), *fjalë mbështetëse analitike karakterizuese* (f. 59), *frazë karakterizuese* (f. 61), *frazë kohore me kuptim të padiferencuar* (f. 64), *frazë kohore me kuptim të diferencuar* (f. 68), *fraza me kufizim fillestar* (f. 71), *fraza me kuptim kohor fundor* (f. 72), *fraza kohore me kuptime të mbishtuara* (f. 74), *fraza pa fjalë mbështetëse analitike kushtëzuese* (f. 84), *fraza përqsure* (f. 115), *fraza lejore përjashtimore* (f. 118), *frazë pa fjalë mbështetëse sintetike* (f. 121), *fraza përcaktore përemërore* (f. 126), *fraza me lidhje kufizuese-dalluese* (f. 134), *frazë me lidhje shtjelluese-shtesore* (f. 139), *frazë me lidhje kufizuese-dalluese* (f. 144), *frazë me fjalë mbështetëse analitike lidhëzore* (f. 147), *frazë përcaktore filluese dëftore* (f. 148), *fraza përcaktore filluese nxitëse a dëshirore* (f. 149), *fraza përcaktore filluese pyetëse* (f. 150), *fraza përcaktore saktësuese* (f. 156-164); kur *fjala është rrethanor kohe, vendi, mënyre, rrethanor sasie, rrethanor shkaku a qëllimi, fjala mbështetëse është kryefjalë a kundrinor i drejtë; fraza me një gjymtyrë krahasimi të mbuluar* (164), *fraza me fjalë mbështetëse sintetike* (165) etj.

Këta terma, ose më mirë të thuhet *togje a vargje fjalësh terma*, nuk janë ngritur në shkallë përdorimi në librat e sintaksës së këtyre 10 vjetëve, as në tekstet e arsimit 9-vjeçar, as në nivelin e shkollës së mesme dhe as në ndonjë libër të kësaj disipline, siç është teksti *Gjuha shqipe – Sintaksa* e autorit Thoma Dhima, prandaj dhe u shënua më lart se shembujt e paraqitur këtu janë krejt të veçanta të gjuhëtarit M. Totoni, i cili, për mendimin tonë, ka një kontribut të dukshëm edhe në zhvillimin e terminologjisë së kësaj lënde dhe emri i tij lidhet me mjaft punime e probleme të diskutueshme në Sintaksën e shqipes

Për ta mbyllur këtë rendje panoramike, duhet shtuar se edhe në tekstin më të ri “Gjuha shqipe - I për shkollat e mesme” Tiranë 2003 (autorë: E. Hysa, Gj. Shkurtaj, Xh. Lloshi, I. Metani, M. Gjokutaj), përdorën kudo me kundërvënien termat *fjali e thjeshtë* dhe *fjali e përbërë*.

Le të përmendim se edhe në “Fjalorin e termave të gjuhësisë” në 6 gjuhë (botim i Akademisë së shkencave të RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1975), janë përfshirë edhe termi *frazë*, edhe termi *periudhë*, duke u vënë këta barasvlerës në gjuhë të tjera: **frazë**: rus. *fraza*, fr. *phrase*, angl. *phrase*, gjerm. *phrase*, it. *frase*; **periodë**: rus. *sllozhnoje predllozhenje*; *period*; fr. *phrase complexe*; *periode*; angl. *complex sentence*; *compound sentence*, *period*; gjerm. *Periode*, *Satzgefüge*, *zusammengesetzter Satz*, it. *periodo*. Termi *fjali e përbërë*, siç e pamë edhe në tekstet universitare të M. Domit, është një përpjekje për të

Periudha, fraza e fjalia e përbërë si njësi sintaksore në gramatikat e shqipes

zëvendësuar termin *periudhë* dhe është futur në gjuhësinë tonë nga Justin Rrota, i cili, duke pasë studiuar në Austri, solli mjaft elemente të gramatikës së gjermanishtes. Lidhur me këtë duhet sqaruar se në Sintaksën e J. Rrotës (1942), krahas termit *fjali e përbame* (f. 60), për të cilën jep shpjegimin “*Fjalija e përbame do të ket pak së pakut dy predikata*” përdoret edhe termi *periudhë* (f. 105) dhe shpjegohet dallimi e lidhja që ka (sipas tij) me termin *fjali e përbame*: “*Sado qi nën këtë emën perjudhë dikush thërret edhe fjalin, qi na ma nalt e quejtem fjali të përbame; prap, ma fort, perjudhë thirret njai grumbull fjalish, ndërtuem me të madhe mjeshtri e hart, qi përmban në veti një mendim të vetëm, por të kryem plotësisht*”. (f. 105), duke pasë shpjeguar që në fillim të tekstit se “*fjalja mund të gjindet, ja veçmas: F. e veçume; ja në lidhni me tjera: F. e përbame*” (f. 6).

Duhet shënuar se gjatë analizës sintaksore të fjalisë së përbërë në të gjitha gramatikat (ku përdoret ky term), ajo zbërthehet në *pjesë*. Po a është emri *pjesë* një skaj gramatikor (sintaksor)? Mendojmë që jo, pasi edhe “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (Tiranë 1980, f. 1943), pas 11 shpjegimeve leksikore që mbart fjala *pjesë*, nën një radhë frazeologjish, jep vetëm dy sintagma me kuptim gjuhësor: “*Pjesët e fjalisë* gjuh. gjymtyrët e fjalisë dhe *Pjesët e ligjëratës* gjuh. klasat kryesore në të cilat ndahen fjalët e një gjuhe, sipas kuptimit të përgjithshëm leksikor, veçorive morfologjike e fjalëformuese dhe funksioneve sintaksore (p.sh.: emri, mbiemri, përemri, folja, ndajfolja, parafjala, etj.). Prandaj mendojmë se nuk është mirë të përdoret fjala *pjesë* si term i sintaksës.”³⁰

Për termin *frazë* (shpjeguar etimologjikisht nga S. Priftit), duhet theksuar se është njësi e gjuhës së folur, e ligjërimit, ndërkohë që fjalia është njësi e gjuhës dhe e ligjërimit. Nga ana tjetër, *fraza*, që nga Shkolla e Pragës e këndej, barazohet me *thënie* (si term i kësaj shkolle, zbërthyer në *temë* dhe *remë*) dhe në disa gjuhësi përdoret edhe në kuptimin e fjalisë, edhe në atë të periudhës (sidomos pas arritjeve gjuhësore të strukturalizmit, deskriptivizmit dhe gjenerativizmit). Për *frazën*, duhet shënuar se ka ndër gjuhëtarët tanë, që me këtë term quajnë edhe fjalinë, edhe periudhën, siç vepron R. Memushaj, kur edhe përcakton se:

“*Fraza është njësia më e madhe fonetike, që paraqitet si një unitet intonacionor dhe kumtues. Ajo është njësia e ligjërimit në gji të së cilës realizojnë funksionet e veta gjithë mjetet prozodike të gjuhës.*”³¹ Për më tepër ky gjuhëtar thekson se *veçimi i frazës nuk paraqet ndonjë vështirësi, pasi paraqitet si segment i rrjedhës që ndodhet midis dy pauzash të gjata, të cilat në të shkruar jepen me shenja ndarëse të pikësimit... dhe kanë intonacion të përfunduar dhe mëvetësi kuptimore,*³² të cilat janë karakteristika të fjalisë dhe njësisë superiore sintaksore – periudhës. Prurjet e mëdha për sintaksën, sidomos nga shkollat e sotme gjuhësore, kryesisht nga gjenerativizmi dhe transformacionalizmi, tregojnë se problemet e kësaj disipline në planin e këtyre drejtimeve të reja, nuk mund të zgjidhen me anë

³⁰T. Topalli, *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë*, Gjuha jonë, 1-4/2004.

³¹R. Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Botime Toena, Tiranë, 2010, f. 167.

³²Po aty, f. 167.

të kësaj terminologjie tradicionale. Veçse terminologjia e re (për gjuhësinë shqiptare) kërkon qëndrime po aq të reja, sipas trajtimit të kategorive sintaksore në rrafshin gjenerativist.

BIBLIOGRAFI

- A. Xhuvani, *Njohunit e para të syndakses shqipe, Pjes'e parë* për klasat e nalta të fillores, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C. Vlorë, 1922.
- A. Xhuvani, *Sintaksa shqip, Pjes'e dytë, për klasët e ulta të shkollavet të mesme*, Shtëpia Botonjëse "Kristo Luarasi", Tiranë, 1938.
- I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C, Vlorë, 1927.
- J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shtypshkronja "A. Gjergj Fishta", Shkodër, 1942-XX.
- K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.
- M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971.
- M. Totoni, *Fraza me nënrenditje*, Shblu, Tiranë, 2000.
- R. Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2010.
- S. Riza, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, libri 13; Prishtinë, 1997.
- T. Topalli, *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë*, Gjuha jonë, 1-4/2004.